



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*  
*Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister*

**Njoftim!**

Njoftohen të interesuarit, student dhe të diplomuar në fushën e drejtësisë, ekonomisë, shkenca sociale, shkenca politike dhe administratë publike) se mund të bëjnë kërkesë për mbajtje të praktikës në Zyrën e Kryeministrit për një periudhë kohore deri në 6 muaj.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë kërkesën së bashku me CV-n, kopje të letërnjoftimit, diplomën ose vërtetimin që është student si dhe çfarëdo dëshmie tjetër të përvojës së mëhershme të punës ose praktikës institucionale.

Kandidatët duhet të kenë njohuri paraprake rreth punës në administratë, hartim të analizave dhe raporteve të ndryshme, hartim legjislacioni, njohuri rreth procesit të konsultimeve publike, njohuri të çështjeve gjinore etj..

Kandidatët duhet të kenë aftësi të përdorimit të programeve të Microsoft Office, aftësi të mira në të shkruar, përgatitjen e prezantimeve të ndryshme si dhe aftësi të mira komunikuese, të jenë në gjendje të punojnë të pavarur por edhe si pjesë e grupeve punuese, të jenë kreativ dhe proaktiv në punë.

Kërkesën së bashku me dokumentet përcjellës i dorëzojnë në arkivin e Zyrës së Kryeministrit, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00 deri më 13 maj 2016.

Vetëm kandidatët CV-t dhe dokumentacioni i të cilëve do të vlerësohet nga Komisioni do të ftohen për intervistë.